

MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

3 - MUJORI - VITI 2015

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË TRE MUJORIT TË VITIT 2015**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për Buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 9.1.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015” paragrafi IV “Monitorimi” Ministria e Kulturës, për 3- mujorin e parë 2015, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore. Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për 3 - mujorin e vitit 2015, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 3– mujori 2015		Realizimi 3– mujori 2015		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	45,481	11.02%	25,983	10.13%	57.13 %
2.	Trashegimia Kulturore	148,397	35.96%	74,780	29.17%	50.39 %
3.	Arti dhe Kultura	218,843	53.02%	155,636	60.70%	71.11 %
	Totali	412,721	100%	256,399	100%	62.12%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	0	0	0	0	0

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se, buxheti është realizuar në masën 62 %, ku rreth 53 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 71 %, ndjekur nga programi ‘Trashegimia Kulturore dhe Muzete’ shpenzimet e të cilit zënë rreth 36 % dhe janë realizuar në masën 50 % dhe programi ‘Planifikim Menaxhimi’ shpenzimet e të cilit zënë rreth 11 % të totali dhe janë realizuar në masën 57 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomike

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3– mujori 2015		Realizimi 3– mujori 2015		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	222,707	54%	206,816	80.7%	92.9%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	130,084	31.5%	45,526	17.8%	35%
12	01110	231	Kapitale	59,930	14.5%	4,056	1.6%	6.8%
			TOTALI	412,721	100	256,399	100	62.1%
12	01110	231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	412,721	100	256,399	100	62.1%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 3-mujorin e vitit 2015 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 93%, shpenzimet korente 35 %, dhe shpenzimet kapitale, janë realizuar në masën 7 %.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në masën 37.9% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për investime.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3– mujori 2015		Realizimi 3– mujori 2015		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	22,017	48.4%	18,770	72.2%	85.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	14,592	32.1%	6,958	26.8%	47.7%
12	01110	231	Kapitale	8,873	19.5%	254	1%	2.9%

MINISTRIA E KULTURËS

			TOTALI	45,481	100	25,983	100	57.1%
--	--	--	---------------	--------	-----	--------	-----	-------

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 57%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 48 % të totalit dhe janë realizuar në masën 85%. Shpenzimet korrente zënë rreth 32% të totalit dhe janë realizuar në masën 48%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 20% të totalit dhe janë realizuar në masën 3%. Mosrealizimi i fondeve në masën 42.9% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në shtatë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit			
		PBA Plan 2015	Buxhet Plan 2015	Buxhet/Plan 3-mujori 2015	Buxhet/Fakt 3-mujori 2015
A-02113	Paisje elektrike dhe elektrike	20,510	22,500	5,791	254
B-01415	Pajisje zyresh	29,528	57,538	8,250	-
C-02459	Akte ligjore e nenligjore	15,010	15,010	7,110	9,200
D-02461	Ristrukturim I strukturave aktuale	14,010	14,010	6,580	4,250
E-04177	Pagesa vendimesh gjyqesore	15,010	15,010	-	-
F-04248	Auditime	16,245	16,245	8,500	6,434
G-02496	Aktmarveshje	21,653	21,653	9,250	5,845
	Totali	131,966	161,966	45,481	25,983

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithshëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për sa i përket produktit “Paisje elektronike dhe elektrike” për këtë 3 muor ka patur planifikim njëkohësisht dhe realizim përmëdim ktu skanerin dhe pajisjet elektronike.

Gjatë 3 mujorit të vitit 2015 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nënligjore” jane planifikuar disa projekt vendime si: Për bashkëfinancim të projektit rikonstrukon i Muzeut Marubi, Rehabilitimi i Amfiteatrit Durrësit.

Në realizimin e Produktit “Nënshkrim Marrëveshjes” gjatë këtij 3 mujori janë nënshkruar disa marrëveshje përmëdim ktu: Nënshkrimin e Programit të bashkëpunimit kulturor midis Ministrive të Kulturës të RSh dhe Maqedonisë 2014-2019, Nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit kulturor midis Ministrive të Kulturës të RSh dhe Bashkisë së Torinos, etj.

MINISTRIA E KULTURËS

Në realizimin e Produktit “Auditime” gjatë këtij 3 mujori janë planifikuar dhe janë audituar disa subjekte përmendim këtu: Bibliotekën Kombëtare, Teatrin Kombëtar Kujtim Spahivogli janë në përfundim Qendra Realizimit të Veprave të Artit dhe Cirku Kombëtasr. Gjatë këtij tre mujori nuk ka patur likuidime për vendimt gjyqësore.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3– mujori 2015		Realizimi 3– mujori 2015		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	68,209	46%	61,830	82.7%	90.6%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	51,687	34.8%	12,950	17.3%	25.1%
12	01110	231	Kapitale	28,500	19.2%	0	34.2%	52.3%
			TOTALI	148,397	100%	74,780	100%	50.4%
12	01110	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	148,397	100%	74,780	100%	50.4%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 50%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 46 % të totalit dhe janë realizuar në masën 91%, shpenzimet korrente zënë rreth 35% të totalit dhe janë realizuar në masën 25 % dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 19% dhe janë realizuar në masën 52%.

Mosrealizimi në masën 49.6 % e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet korrente.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë					08220
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit				
		PBA Plan 2015	Buxhet Plan 2015	Buxhet/Plan 3-mujori 2015	Buxhet/Fakt 3-mujori 2015	
A-00324	Muze Kombetare me standarte dhe shërbime të përmirsuara	174,597	174,597	26,641	22,844	
B-00324	Infrastruktura arkeologjike, monumentale, peizazhistike në Parqet Arkeologjike	19,971	108,042	12,523	4,601	
C-00324	Objekte “monument kulture” të konservuara dhe restauruara	224,361	224,361	74,019	42,633	

MINISTRIA E KULTURËS

D-00324	Aktivite te trashegimise jomateriale dhe diversitetit kulturor te realizuara	67,058	67,058	32,682	2,604
E-00324	Katalogimi i vlerave te trashegimise kulturore materiale dhe jomateriale	11,088	11,088	2,532	2,099
	Totali	497,075	585,146	148,397	74,780

Produktet e planifikuara në këtë program në përgjithësi janë realizuar me perjashtim të Shpronsimit.

Objekte "monument kulture" te konservuara dhe restauruara

Në përmbushje të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës :“Të ruajë, mbrojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor gjatë vitit 2015 vazhdon t’i kushtojë vëmendje të madhe rehabilitimit të Monumenteve të për t’i shndërruar ato në produkte turistike kulturore.

Gjatë vitit 2015 është planifikua restaurimi i dy objekteve monument kulture, kisha e "Ristozi" në Mborje dhe Kisha e shën Spiridhonit, Vuno për të dy objektet ka filluar puna për restaurimin e tyre.

Në vazhdim të eksperiencës së vitit 2014 në menaxhimin e fondeve për mirmbajtjen e monumenteve të kulturës si dhe shtesa në art 602 për mirmbajtjen e monumenteve të kulturës janë marrë masat për përdorimin me efektivitet të lartë të këtyre fondeve me synim mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës nëpërmjet konservimit, konsolidimit, restaurimit të tyre kështu:

Kjo politikë financiare e buxhetore sjell një përdorim dhe shfrytëzim me efikas dhe më efektiv jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të forcave njerëzore dhe punëtore pranë institucioneve të trashëgimisë kulturore.

Falë edhe bashkëpunimit me pushtetin vendor, donatorë dhe persona privatë do të restaurohen, mirëmbahen, konsolidohen, pastrohen nga vegjetacioni, shpëtohen nga gjendja kritike, etj shumë objekteve Monument Kulture, site arkeologjike, park arkeologjik etj.

Gjatë vitit 2015 parashikohet të kryhen restaurime e mirëmbajtje konsolidime nga të gjitha institucionet e Trashëgimisë Kulturore janë në fazën e tenderimit të fondeve apo të miratimit të projekteve në IMK.

Deri tani janë kryer punime mirmbajtese, konsolidimi pastrim vegjetacioni në DRKK Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastër, Vlorë në objektete trashëgimisë kulturore për përgatitjen e objekteve për sezonin turistik.

Do të kryhen restaurime, mirmbajtje e konsolidime në banesa monument kulture, në muret e kalasë, muret rrethues ura, mirëmbajtjeje restauruese e konsoliduese, dhe pastrim nga vegjetacioni i monumenteve etj.

Muze Kombetare me infrastrukture te permirsuar

- Muzealizimi dhe hapja per publikun I katit te pare te Muzeut Arkeologjik Durres. Ky process vazhdon dhe Brenda vitit perfundon dhe kati I dyte dhe trete I tij
- Pavioni etnografik në MHK është në fazën e mbylljes së punimeve teknike dhe do vijojë me muzealizmin e tij.
- Muzeu I Fotografsë Marubi, eshte ne process fillimi I zbatimit të projektit të restaurimit të godines.
- Ngritja e muzeut të ri të përgjimeve “shtëpia me gjethe” është hartuar projekt-idea per muzealizimin dhe ka filluar zbatimi i projektit të restaurimit të godines.

Katalogimi I vlerve të trashëgimisë kulturore material dhe jomateriale.

- Në kuadër të krijimit të Fondit Kombëtar të Traëshëgimisë Kulturore, MK në bashkëpunim me QKIPK vazhdon procesin e katalogimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në fushat Arkeologji, Art Pamor, Etnografi, Arkitekture etj
- Kartela të reja në Katalogun “Onufri”, ku janë kataloguar objekte që I përkasin kryesisht institucioneve shteteore janë 2270
- Kartela të reja në katalogun “Maro Kondi” ku janë kataloguar objekte që I përkasin personave private janë 1290

Ky process vazhdon dhe përditesohet cdo dite si nga ana e institucioneve që administrojne vlere të trashëgimisë kulturore dhe QKIPK.

Parqe Arkeologjike me infrastrukture te permirsuar

Projekti “Rehabilitimi i manastirit te Shen Marise dhe perisazhi i sitit arkeologjik te Apollonise.

Projekti ishte planifikuar per te filluar vitin e kaluar 2014. Procedurat e tenderimit te punimeve te restaurimit dhe supervizimit te punimeve ne kuader te ketij projekt kryhen nga Delegacioni i BE

ne Shqiperi. Ky i fundit nuk ka perfunduar ende procedurat ne fjale per pasoje punimet ne kuader te ketij projekti nuk kane filluar ende.

Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit te Parqeve Arkeologjike kryejnë në vazhdimësi:

-Mirmbajtje te teritorit si pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët.

-Katalogim te vlerave te trashegimise kulturore materiale e jomateriale: “Plotësim i kartelave të Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme”,

Në këto parqe zhvillohen dhe shumë aktivitete të trashëgimisë materiale, jomateriale dhe diversitetit kulturor.

Aktivite te trashegimise jomateriale dhe diversitetit kulturor te realizuara

Produkti i planifikuar (parashikuar) nje vit me pare, nuk është realizuar për tremujorin e parë pasi nuk u zhvillua thirrjeje per trashegimine kulturore permes te ciles te mbeshteteshin aktivitete nga te tretet.

Ministria e Kulturës është e angazhuar në përgatitjet e Festavilit Folklorik Kombëtar të Gjitrokastrës për të cilën u bë një shtesë fondi në vlerën 90,239,500 lekë.

Janë zhvilluar aktivitete të kuadër të projektit Miku i Monumentit dhe aktivitete në kuadër të 8 prilli Dita Nderkombetare e Romeve, 18 prill Dita ndërkombëtare e monumenteve të Kulturës dhe Siteve, etj.

3. **Programi: “ARTI DHE KULTURA”**

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3– mujori 2015		Realizimi 3– mujori 2015		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	132,481	60.5%	126,216	81.1%	95.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	63,804	29.2%	25,618	16.5%	40.2%
12	01110	231	Kapitale	22,558	10.3%	3,801	2.4%	16.9%
			TOTALI	218,843	100%	155,636	100%	71.1%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 71%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 61% të totalit dhe janë realizuar në

masën 95%. Shpenzimet korrente zënë rreth 29% të totalit dhe janë realizuar në masën 40%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 10% dhe janë realizuar në masën 17%.

Mosrealizimi i fondeve në masën 28.9% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi		Arti dhe Kultura				08230
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit				
		PBA Plan 2015	Buxhet Plan 2015	Buxhet/Plan 3-mujori 2015	Buxhet/Fakt 3-mujori 2015	
A-00325	Veprimtari të realizuara në institucionet e art kultures	682,349	682,349	182,843	132,261	
B-00325	Veprimtari të realizuara me fondet e programit art kultures	90,000	130,499	32,200	19,575	
C-00325	Perfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombetare	14,880	15,200	3,800	3,800	
	Totali	787,229	828,048	218,843	155,636	

Drejtorja e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës bazuar në Ligjin nr. 10352, dt.18.11.2010, (neni 26), “Për Artin dhe Kulturën”, referuar në objektivat prioritare për Ministrinë e Kulturës, ka realizuar me sukses gjithë procedurat administrative në kuadër të thirrjes publike për mbështetje të projekt-propozimeve në fushën art-kulturë për vitin 2015.

Përsa i përket veprimtarive të realizuara pranë institucioneve qëndrore të artit dhe kulturës në vend për periudhën janar-mars 2015, një hapësirë të rëndësishme zë nisja nga puna për përmirësimin e infrastrukturës për ato institucione të cilat ndodhen në gjendje emergjente për nga ndërtesa fizikisht si psh: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, dhe Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë, etj.

Rikonstrukcioni i tyre nuk ka penguar së realizuari kalendarët e pasur artistik të programuar dhe miratuar nga bordet artistike të secilit institucion. Përmendin realizimin e disa prej premierave botërore dhe krijimin e hapësirave të reja për artistët e elitë. Një tjetër tregues pranë këtyre institucioneve ka qenë rritja e audiencave dhe zgjerimi i hapësirave edukuese përmes artit dhe kulturës për brezin e ri.

Gjithashtu referuar periudhës janar – mars 2015, ka patur rritje të dukshme përfaqësimi i produktit artistik shqiptar, në disiplina të ndryshme të artit dhe kulturës, përmes aktiviteteve të realizuara në veprimtari prestigjioze ndërkombëtare, të cilat kanë përfaqësuar Shqipërinë denjësisht.

Për më tepër;

Thirrja për projekt propozime në Art – Kulturë e cila ishte e hapur deri më dt. 9 janar 2015, për projektet - propozime të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën për gjithë vitin kalendarik 2015, u finalizua me sukses.

Duke respektuar afatet e paracaktuara të publikuara për të interesuarit pranë faqes elektronike të MK, filloi nga puna ndjekja e të gjitha procedurave administrative nga drejtoritë e përmbajtjes dhe ato të linjës këtu.

Faza e I-rë, ndjekja e procedurave nga grupi i punës i ngritur me Urdhër Minisri nr. 331 prot, dt.17.11.2014, me objekt shqyrtimin e dokumentacionit, plotësimit të formularit (chek list) për vlerësimin e projekt propozimeve të paraqitura në përshtatje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin dhe formularit të aplikimit/preventivit tip, ku u shqyrtuan rreth 300 projekt propozime.

Faza II-të, Shqyrtimi i projekt propozimeve nga kolegjiu dhe ekspertët e jashtëm.

Faza e III-të, Vendimi i Kolegjiut, ku u përzgjedhën projektet fituese. Përzgjedhja e tyre u bazua në kriteret e shpallura në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime për vitin 2015.

Faza e IV-të, Urdhri i Ministres me nr.331/4 dt.09.02.2015, “Për financim dhe mbështetje me fonde publike të projekteve me aplikim, për vitin 2015”, duke marrë parasysh Vendimin e Kolegjiut Nr.626, datë 9.2.2015, referuar këtij urdhri u mbështetën 82 projekt-propozime në shumën totale prej 47.654.000 zëri “604”, nga aparati “Projekte në art”.

Faza e V-të, shpallja e fituesve pranë ëeb-site të MK, www.kultura.gov.al

Faza e VI-të, lidhja e kontratave me secilin nga përfituesit.

Faza e VII-të Monitorimi dhe likuidimi finaciar sipas secilit projekt.

Gjithashtu përmendim realizimin e disa prej projekteve kryesore të brendshme, në fusha të ndryshme të artit:

- Onufri XXI 2015;
- Kalendar i përbashkët kulturor Shqipëri – Kosovë dhe Diasporës;
- Kinemaja dhe filmi shqiptar nëpër botë;
- Ndjekja dhe përgatitja i gjithë dokumentacionit dhe procedurave administrative për Pjesëmarrjen e Shqipërisë në edicionin e 56-të të ekspozitës ndërkombëtare të artit në Venecia, Itali 2015;
- Artistë in Residencë- Rezidencë artistike në Salsburg-Austri. Artistja e përzgjedhur znj.Yllka Gjokopulli Gjolllesha;
- Përfundimi i restaurimit të 2 filmave shqiptar pjesë e fondit të AQSHF, me mbështetje fiananciare të MK, “Përrallë nga e kaluara” dhe “Përjetësi”.

❖ ***Promovimi i imazhit dhe artit shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe sjellja e eksperiencave më të mira të artistëve shqiptarë që jetojnë jashtë në skenat e vendit.***

Disa nga Premierat apo veprimtaritë më kryesore pranë institucioneve qëndrore në vend, për periudhën Janar-Mars 2015,

Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, Ansambli Popullor

- “Suor Angelica” dhe “Gianni Schicchi”, me pjesmarrjen e Ermonela Jaho dhe Gëzim Myshketa.
- Premierë opera “Le nozze di Figaro” E.A .Mozart, me pjesmarrjen e sopranos Oriana Kurteshi.
- Premierë Baleti “La Sylphide”, dirigjent Stefano Ligoratti, Koreografia Ilir Kerni.
- Përfaqësues të TKOBAP pjesëmarrës në Sofie, Bullgari në kuadrin e realizimit të shfaqjes Premierë “Tristan dhe Isolde”, në datat 26-28 Shkurt 2015.
- Përfaqësues të TKOBAP, pjesë e delegacionit të Kalendarit të Përbashkët midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Shqiptare. Kalendari Kulturor Shqipëri Kosovë dhe Diasporë.

Galleria Kombëtare e Arteve

- Sigmar Polke- 40 vizatime “Muzikë nga një burim I panjohur”.
- Realizmi Socialist- “Again”.
- Ekspozitë “Punëtorët dalin nga studioja, duke mos parë me realizëm socialist”.
- Përfaqësues të GKA, pjesë e delegacionit të Kalendarit të Përbashkët midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Shqiptare. Kalendari Kulturor Shqipëri Kosovë dhe Diasporë.

Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Teatri i Kukullave

- Konkursi i projekteve për premierat e Teatrit të Kukullave.
- Aktivitet kulturor me fëmijët e QKKFTK në Prizren, në kuadër të ditës së Pavarësisë së Kosovës.
- Edicioni i III- të Festivali i kërcimit për fëmijë “Ne jemi Bota”
- Edicioni i XVIII-të I “Festivalit për zërat e rinj”
- Realizimi i disa Premierave teatrale për fëmijë.
- Përfaqësimi i Shqipërisë, në Festivalin Ndërkombëtar të 37-të të Fëmijëve, që do të zhvillohet në datat 15 deri më 23 prill 2015, në Antalia, Turqi.
- Përfaqësimi i Shqipërisë, në “Festivalin ndërkombëtar të Fëmijëve 23 prill 2015”, në Edirne, Turqi.

Cirku Kombëtar

- Projekti “Suprizat e Pranverës”
- Projekti “Guidë”

Teatri Kombëtar

- Premierë “Vrasja e Zhan Pol Maratit
- Premierë “Gruaja në Dritare”

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit

- Restaurimi i 2 filmave artistik “ Përrallë nga e Kaluara” dhe ‘Përjetësi”
- Projekti Gratë Krijuese.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,